

MICHELLIS DESIGN

Jemi përpjekur dhe munduar shumë që të arrijmë një cilësore dhe që t'u ofrojmë lexuesve aktualitetet dhe ngjarjet më interesante të kohës sonë. Ju kërkojmë pjesë nëqoftëse hasni në gabime të ndryshme, apo vëreni donjë mangësi. Ndërkohë kemi një falemderim të madh për profesorët, personelin arsimor dhe nxënësit që kontribuan në realizimin e revistës sonë.



Kryeredaktor :
Ali Doda, prof.

Lektor:
Islam Hoti, prof.


Realizimi kompjuterik:
Genc Hollaj IV-3

Redaksia:
Eliana Hasanaga IV-3
Veneta Berisha IV-3
Arta Mollabeqiri IV-3
Zana Kovaçi IV-4
Arta Cungu III-5
Rita Lulgjuraj III-6
Ulkiana Tela III-4
Nora Tafica II-5
Fjolla Bisha II-5
Alba Antoni II-5

mbajtja :	
ualitet	4
kursioni	6
ervista	8
ti Psikologjik	9
imtari	10
turë	12
ale	16
nor	17
la	18
vani i katër viteve...	20

Adoleshentët dhe interneti

*B*ota është plot çudira, por çudia më e madhe nga të gjitha është njeriu... Ky kur era fryrë furishëm, detin çanë përmes. Dhe kështu i bartur nga era veproi dhe shpiku ca gjëra të pa imagjinueshme për gjyshërit tanë (kompjuterin, celularin, etj.) E shkuara veproi që e ardhmja të na gjente më mirë. Dhe ja ku jemi, ne një botë me kushte më të mira se ndonjë herë më parë. Por në këto kushte hyjnë gjëra të reja, me komplekse, si p.sh. interneti. Interneti? Pikepyetja që po e shqetson njerzimin. Dhe lidhet me adoleshencën me një relacion të pandashëm. Sepse moshatarët tanë janë ndër përdoruesit më të gjërë të internetit. Por a ka keqpërdorime inerneti, apo perdoret në një mënyrë perfekte? Pasi moshatajone është e luhatshme, siç thotë populli "ka të fryejnë erërat" edhe internetin e përdorin në të dy aspektet.



Ai me të vërtetë na jep mundësi të mëdha, por jemi ne ata që zgjedhim se për çka ta përdorim. Dhe ai po shndërrohet në një sëmundje ngjitëse dhe të pa shërueshme. Adoleshentët mendojnë cekët, pasi karakteri i tyre si person s'është formuar ende. Ja, edhe një arsye e keqpërdorimit. Sikur ne të shfrytezojmë më pak kohë në internet, të mendojmë më pak për kënaqësitë e çastit, e më shumë për pasojat dhe problemet që mund të dalin pas, do ishte edhe më i mirë. Edhe blerjet kryejmë përmes internetit, gazetatat i lexojmë po aty. Botën shohim nga njëri cep në tjetrin, dhe mendojmë se jetën mund ta kalojmë aty. Jo, mesazhi im është: Mos përdorni vetëm kompjuterin, përdorni më shumë kokën. Kompjuteri s'është gjëja më e mendshme, ne e kemi krijuar. Por të shpresojmë që "era" të fryjë përsëri dhe njeriu të gjejë "kurën" dhe për këtë.

Admir Halili I-4

2012 - JEMI SUPERSTICIOZ APO JO?!

kalimtar të kësaj bote, që do ta prekim fundin shpejt, apo ndoshta kemi akoma ecje pa mbarim se ende është larg?!

ra frymë, mendoj thellë, por është e kotë, nuk mbërrij askund. Pyes dhe vetëm pyes po askush gjegjë s'më jep?!

hte m'vull të gjithë janë të tmerruar nga fakti se 2012 është vërtetë fundi tyre, dhe mundohen sa më shumë ta injorojnë vetpërmendjen e këtij fenomeni?

p.sh. thjeshtë nuk i besojnë, dhe as që lodhen që të shpjegojnë një fakt të tillë, sepse është e kotë, është gjitha një tragjedi e thurur nga ndonjë komedian?!..

mirëpo, çfarë në të vërtetë është "Apokalipsi 2012"?

shoh se "Apokalipsi 2012" është thjesht një libër nga fizikanti amerikan Laurenc Xhozef, ku thuhet se pas vetëm 2 viteve në Tokë do të mbretërojë ferri...

shikim të parë do të thoja se është ndonjë libër që nesër do të bëhet me famë botërore vetëm nga fakti se mund të shprehet si ndonjë film, çka edhe është realizuar...

mirëpo, Xhozef ecën shekuj mbrapa me investigime dhe bindjet e tija bazohen se më 12 dhjetor të vitit 2012 do të përfundojë cikli i kalendarit Maja, qytetërim misterioz që banoi në Amerikën Qëndrore nga viti 1800 p.e.r. deri në vitin 1450 pas e.r.

er më shumë të nesërmen do të ndodhë solistici dimëror dhe dielli do të pozicionohet me qendrën e rrugës së Qumështit për herë të parë pas 26 mijë vjetësh...

uke lexuar këto të dhëna, tmerrohem...

shoh më tej dhe shoh se disa e lidhin këtë histori me Nostradamusin (Michel de Notre – Dame 1503-1566), mirëpo, asnjë fakt nuk lidhet me 2012 dhe katasrofën e parashikuar..

është fakt tjetër më tërhoqi vëmendjen më tepër. Katasrofa të tilla janë parashikuar gjithmonë që nga viti 1979 deri më 2008, por asnjë nuk rezultoi e vërtetë.. E vetmja tragjedi e shkakëtuar nga këto "parashikime" është humbja e jetës së 39 personave në vitin 1997, të cilët u vetëvranë me shpresën do të arrinin në një "nivel superior" përpara se bota të shkatërrohej.

çfarë duhet të ndërmerrem ne?!.. Ndoshta duhet rezervuar vendet për në anijet gjigante të vitit 2012? Po numrin e kontaktit ku ta gjej, ku ta kërkojë?! Apo thjeshtë të presim dhe të mos ndërmerrem një parandalim nga kjo katastrofë!!?

arëdo që të ndërmerret është e kotë, sepse një bindje që thellohet së tepërmi mund të ketë rrënjë të thella dhe politike, mbi të gjitha nëse përcillet nga persona që kanë pozicione të fuqishme..

si, termetet dhe çdo fakt natyror janë të paparashikueshëm.. E vërtetë që teknologjia nga dita në ditë ecën përpara dhe ndoshta jo e gjitha është e pasaktë nga parashikimet e tyre, mirëpo janë gjëra të tilla si syri e as dora e njeriut mund ti shoh e parandalojë dot.

influencohesh nga mendimi i një apokalipsi do të thotë ta lëshosh vehten në një rrjedhje mendimesh duke bërë asgjë për ta parandaluar, sepse çdo gjë është e shkruar nga dikush atje lart dhe ne thjesht bijmë të këtij universi Apokalipsi..

2012 - JEMI SUPERSTICIOZ APO JO?!

kalimtar të kësaj bote, që do ta prekim fundin shpejt, apo ndoshta kemi akoma ecje pa mbarim se ende është larg?!

doj, mendoj thellë, por është e kotë, nuk mbërrij askund. Pyes dhe vetëm pyes po askush gjegjë s'më jep?!

is vallë të gjithë janë të tmerruar nga fakti se 2012 është vërtetë fundi tyre, dhe mundohen sa më shumë ta injorojnë vetpërmendjen e këtij fenomeni?

thjeshtë nuk i besojnë, dhe as që lodhen që të shpjegojnë një fakt të tillë, sepse është e kotë, është gjitha një tragjedi e thurur nga ndonjë komedian?!..

mirëpo, çfarë në të vërtetë është "Apokalipsi 2012"?

mirëpo, "Apokalipsi 2012" është thjesht një libër nga fizikanti amerikan Laurenc Xhozef, ku thuhet se pas vetëm 2 viteve në Tokë do të mbretërojë ferri...

shikim të parë do të thoja se është ndonjë libër që nesër do të bëhet me famë botërore vetëm nga fakti se mund të shprehet si ndonjë film, çka edhe është realizuar...

mirëpo, Xhozef ecën shekuj mbrapa me investigime dhe bindjet e tija bazohen se më 12 dhjetor të vitit 2012 do të përfundojë cikli i kalendarit Maja, qytetërim misterioz që banoi në Amerikën Qëndrore nga viti 1800 p.e.r. deri në vitin 1450 pas e.r.

ër më shumë të nesërmen do të ndodhë solistici dimëror dhe dielli do të pozicionohet me qendrën e rregës së Qumështit për herë të parë pas 26 mijë vjetësh...

uke lexuar këto të dhëna, tmerrohem...

exoj më tej dhe shoh se disa e lidhin këtë histori me Nostradamusin (Michel de Notre – Dame 1503-1566), mirëpo, asnjë fakt nuk lidhet me 2012 dhe katasrofën e parashikuar..

ijë fakt tjetër më tërhoqi vëmendjen më tepër. Katasrofa të tilla janë parashikuar gjithmonë që nga viti 1979 deri më 2008, por asnjë nuk rezultoi e vërtetë.. E vetmja tragjedi e shkakëtuar nga këto "thashetheme" është humbja e jetës së 39 personave në vitin 1997, të cilët u vetëvranë me shpresën e do të arrinin në një "nivel superior" përpara se bota të shkatërrohej.

Po çfarë duhet të ndërmerrem ne?!.. Ndoshta duhet rezervuar vendet për në anijet gjigante të vitit 2012? Po numrin e kontaktit ku ta gjej, ku ta kërkoj?! Apo thjeshtë të presim dhe të mos ndërmerrem asnjë parandalim nga kjo katastrofë!!!?

Çfarëdo që të ndërmerret është e kotë, sepse një bindje që thellohet së tepërmi mund të ketë rrënjë sociale dhe politike, mbi të gjitha nëse përcillet nga persona që kanë pozicione të fuqishme..

Apokalipsi, termetet dhe çdo fakt natyror janë të paparashikueshëm.. E vërtetë që teknologjia nga dita në ditë ecën përpara dhe ndoshta jo e gjitha është e pasaktë nga parashikimet e tyre, mirëpo janë gjëra të cilat as syri e as dora e njeriut mund ti shoh e parandalojë dot.

influencohesh nga mendimi i një apokalipsi do të thotë ta lëshosh vehten në një rrjedhje men- shesh duke bërë asgjë për ta parandaluar, sepse çdo gjë është e shkruar nga dikush atje lart dhe ne nuk mund të ndryshojmë asgjë. Në të vërtetë, ne jemi thjesht bijë të këtij universi Apokalipsi..

Sa është “reformuar” shkolla nga reformat?

Intervistë me pedagogen e shkollës Znj. Fatmire Molla për reformat shkollore.

1. Si e gjetën reformat shkollën tonë?

Pedagogia: Edhe pse çdo reformë tërheq pas vetes probleme të caktuara ato çdo herë e më tepër duke u zgjedhur. Kontributin maksimal në këto drejtime janë duke e dhënë Kryesia e shkollës dhe mësimmshënësit.

2. A mendoni se profesorët ishin të përgaditur të kalonin nga metoda klasike në atë të reformuar?

Pedagogia: Duke ndjekur seminare të ndryshme, në lidhje me mësimin bashkëkohorë, mësimmshënë gradualisht janë duke u qasur në thelb të metodave bashkëkohore.

3. Dimë që në fund të vitit maturantët do mund të diplomohen, vetëm nëse kalojnë provimin maturës. Sa mendoni ju se është shkalla e vështirësisë të këtyre provimeve?

Pedagogia: Provimi i maturës shtetërore verifikon të arriturat tuaja gjatë katër viteve shkollore. Pra, kjo varet nga ju se sa jeni përgaditur gjatë këtyre viteve.

4. Pasi që e dimë se nuk kishim tekste në gjuhën shqipe, dhe nxënësit nuk janë aq të përgaditur mendoni se do kemi sukses apo do të dështojmë?

Pedagogia: Mësimmshënësit iu kanë ofruar të gjitha njësitë mësimore të parapara sipas plan-program ashtuqë ditët e sotme në lidhje me mësimin dhe njohuri të tjera, të reja, mund të gjenden edhe përmes internetit.

Mungesa e teksteve mësimore nuk them që nuk është pengesë, por mund të tejkalohet me një punë më të madhe duke kërkuar këto informata në burime të ndryshme. Atëherë edhe suksesi do të jetë pashmangshëm.

5. Një këshillë për maturantët?

Pedagogia: Koha që ju ka mbetur ta shfrytëzoni duke mësuar, sepse arsimimi është e ardhmja juaj e këtë njohuri do ua përcjellni gjeneratave të ardhshme. Arsimimi juaj paraqet një nga shtyllat themelore të identitetit shpirtëror dhe intelektual të shoqërisë në të cilën jetojmë. Ju dëshiroj suksese. Faleminderit!

Test psikologjik

Test psikologjik. E shkuara, e sotmja dhe e ardhmja

Je një tip që jeton të sotmen, apo pëlqen t'i projektosh gjërat? Apo preferon ta jetosh jetën ditë pas dite? Apo jeton ende me të kaluarën?

1 - Të jesh e suksesshme, është çelësi i jetës ende?

1. Sigurisht, është vërtet shumë e rëndësishme.

2. Po, përveç faktit që kjo të mos ndikojë në cilësinë e jetës sime.

3. Nëse do të ishte e mundur, do të më pëlqente.

3 - Punën e zgjedh mbi gjithçka?

1. Jo, përparësi për mua është familja.

2. Do të privilegjoja dëshirat dhe ëndërrat e momentit.

3. Do ta quaja kompetencë të momentit.

7 - Një histori e bukur dashurie varet...

1. Nga momenti kur e ke përjetuar.

2. Kur të surprizon nga të rejtat që të sjell.

3. Kur rritet bashkë me projektet për të ardhmen.

7 - Mbas dhjetë vjetësh do të jesh...

1. E martuar me dy fëmijë dhe me një pozicion të mirë profesional.

2. Nuk e di dhe nuk e shoh si një problem.

3. Shpreson të jesh ndryshe nga nëna jote.

D - Shëndeti për ty konsiderohet...

1. Nëse do të kisha një patologji në familje, do të isha në merak.

2. Çdo ditë e re, me një rregull të ri për shëndetin.

3. Shëndeti është i rëndësishëm, por të jetosh në harmoni është edhe më e rëndësishme.

Dh - Një natë çmendurie është...

1. Më e mirë se çdo gjë tjetër.

2. E bukur nëse nuk ndodh shpesh, sepse pastaj do të bastardohej.

3. Nuk do të hiqja asnjëherë dorë prej saj.

E - Historitë e familjes...

1. I njeh përmendësh dhe ke gjithmonë konsideratë për to.

2. I përket të kaluarës, nuk më intereson.

3. Është e rëndësishme, por jo sa e ardhmja.

F - Ekologjia dhe e ardhmja e planetit...

1. Është e rëndësishme, dhe e mendoj çdo ditë.

2. Është e rëndësishme ta mendosh, nëse do

Më shumë përgjigje 1

Je e projektuar drejt së ardhmes Është e ardhmja ajo që të preokupon më tepër se çdo gjë tjetër. Energjitë e tua shkojnë drejt projekteve, që kanë të bëjnë me të ardhmen. Për ty, kuptimi i të jetuarit është të ëndërrosh si do të jetë e ardhmja. Ajo që ka mëndësi për ty, është ajo që duket e vërtetë. Je e një futuriste.

Më shumë përgjigje 2

Je e drejtuar nga e kaluara Sigurisht, e kaluara është mikja me të cilën udhëton më shumë. Nuk e jeton dot të sotmen, nëse nuk mendon të kaluarën. Çdo moment është i ndërtuar falë një sekuence që e ka origjinën nga e djeshmja. Për ty, jeta nuk duhet ta braktisë kurrë origjinën e saj. Historitë janë këshilla për ty. Je një femër gjithmonë në kërkim.

Më shumë përgjigje 3

Je e përqendruar tek e sotmja Është e sotmja, ajo që ka më shumë rëndësi për ty. I shijon kënaqësitë që të fal jeta ditë pas dite; nuk harxhon si dhe nuk hedh poshtë asnjë minutë dot. Je e përqendruar tek ajo që të ndodh në moment dhe e ke hedhur pas krahëve të shkuarën. Ajo i përket së djeshmes, ndërkohë që ti i përket të sotmes. Jeton nga instinktët dhe je një grua egoiste.

“BËMAT E DASHËRISË”

Shumë njerëz ecin nëpër botë duke e kërkuar,
por s'mund ta gjejnë askund se ajo nga pas i ndjek.
Shumë të tjerë thojnë është vetëm ëndërr,
sa shumë përpiqet për t'i zgjuar.
Tjerët thojnë është iluzion i përkohshëm,
kurse ajo mundohet për t'iu kundërshtuar.
Shumë e kritikojnë, shumë nga vetja e largojnë,
i frikësohen, nuk e dojnë ...

Mirëpo, ajo vë në lëvizje botën!
Duke përdorur maskën e saj prej xhamit
Ajo është një fuqi shumë e mrekullueshme,
dhe në të njëjtën kohë po aq e tmerrshme,
Aq e bukur edhe aq e shëmtuar,
sa hyjnore po aq edhe njerëzore.
Mbase nga të gjitha është gjëja më e mistershme.
Për “bëmat” e saj, ndonjëherë, a keni dëgjuar ?

A keni dëgjuar çfarë ndodhi?
“Ai” dha jetën për “të”,
“Ajo” preu damarët e duarëve se “ai” nuk e donte më...
“Dy shokët” më të ngushtë prishën miqësinë
(se hyri në mes dashuria).
“Ai” ra në komë, “ajo” ne depresion
Një tjetër budalla ra në lum
Se po drejtonte makinën i dehur (nga dashuria).

Në emër të saj vriten, priten, luftojnë,
Kundërshtojnë prindërit dhe botën,
duke nisur fluturimin (pa aeroplan).
Vetëm, kundër të gjithëve
dhe duke bërë çdo gjë,
saqë në fund s'iu mbetet më asgjë.

Asgjë, përpos një shkretëtire ku mbizotëron zhgënjimi,
Sepse në këtë jetë njeriu
ose vdes i zhgënjyer nga dashuria,
ose nuk jeton mjaft gjatë saqë të shohë
zhgënjimet që bie dashuria.

Megjithatë, sot të gjithë merren me dashuri,
prandaj, ajo ka marrë hov dhe liri të pakufi.
Për të krijohen thashethemet më madhështore,
shkruhen libra nga më të bukurit, krijohen këngë, filma
Pra, mbi të gjitha dashuria përsëri mbijeton
dhe mbi këtë botë krenare mbizotëron!

Jeta – jetë , nuk mund ta kundërshtosh jetën !

Pasi lindëm,deri në fund le të jetojmë,
Dhe të vdesim
duke shpresuar se do të kuptojmë
se për çfarë kemi jetuar.

E vetmja rrugë
të dalësh "gjallë"
nga labirinti i jetës
është duke vdekur.

Kjo është e trishtueshme,
por , edhe më e trishtueshme është
se ky është mekanizmi i jetës.

Nuk mundesh në shi të qëndrosh,
e në vendin tënd të laget dikush tjetër .

Nuk mundesh diçka të fitosh,
e që përpara mos ta kesh ëndërruar.
Nuk mundesh t'i thuash erës mos fryjë,
As peshkut mos noto.

Nuk mundesh jetën sipas qejfit ta ndyshosh.

Prapëseprapë,njeriu – njeri,
punon,krijon,mundohet,grumbullon,
duke mbyllur sytë para asaj
se njerëzit që shkuan
asgjë me vehte nuk s'morën.
Përcjellë varrimet të tjerëve
dhe prapë bën sikur vetë
nuk do të vdes kurrë
apo ndoshta

sikur do të vdes dikush tjetër në vend të tij.

Mirëpo,jeta –jetë ,çfarë t'i bësh jetës,
s'mund ta kundërshtosh atë,
dhe s'mundesh as ta lavdërosh.

Ajo gjithmon në fund
e gjen ekuilibrin e vet!

Veneta Berisha IV-3

Më mungon...

Më mungon ti...më mungojnë këshillat
tua
më mungon dashuria yte, dhe fjalët tua
"bij, të dua",
më mungon kujdesi yt, puthjet dhe led-
hatimet,
më mungon ti Nënë, më mungojnë
përqafimet.

Më mungon të kërkoj falje, më mungon
të të kem pran,
më mungon gjiri yt, kokën time të ta
mban,
më mungon të t'them të dua dhe nuk
ç'mallem dot,
më mungon nënë mua, çdo ditë sikur sot.

Më mungon fytyra yte ëngjëllore, nënë,
bukuria yte, që s'krahasohej dot me hënë
mirësia yte dhe fjalët që mi thoje,
Nënë, ishe ti e vetmja që më kuptoje.

Mundohem kokën lart ta mbaj, ashtu si
m'ke mësuar,
me lotët e heshtur qaj, për të mos u dal-
luar.
S'e kuptoj dot pse më le, kurrë s'kam për
t'kuptuar,
je bër engjull në Parajsë, në tokë mbetesh
e paharruar.

Liridona Seferi IV-3

“Veshja popullore në qytetin e Ulqinit në shekuj”

Ulqini, qytet i lashtë bregdetar, në sistemin e tregut ndërkrahinor të Shkodrës, kjo qendër kryente funksionet e një skele tranziti të dorës së parë. Në shek. XVIII Ulqini ishte një qytet me 10.000 banorë, të cilët merreshin kryesisht me lundrim dhe tregti. Ulqinakët, detarë të zotët, preknin me anijet e tyre vetëm skelat e detit Adriatik, por edhe ato të detit Mesdhe. Tipat e veshjeve qoftë në tërësi, qoftë në elementet e veçanta të tyre, nuk kanë të njëjtën moshë dhe origjinë. Renditja e tipave të veshjeve bëhet duke marrë parasysh dy faktorë: vjetërsinë e tyre dhe shkallën e shtrirjes.

Veshjet popullore shqyrtohen në dy grupe të mëdha që janë: Veshjet për burra dhe veshjet për gratë. Veshja për burra (me brekushe) është tip veshjeje për ku pjesa që karakterizon kostumin janë “brekushet” apo “brakeshat”, lloji i pantalloneve të gjata deri te nyjet e këmbëve dhe disi të gjëra, të prera njësoj si mbathjet e gjata të burrave. Ato mund të ishin prej liri apo pambuku, për stinën e veshjeve ose prej leshit të shkelur, për dimër. Në pjesën e sipërme të trupit burri vishte një këmishë me mënyrë të gjata dhe mbi të jelekun e xhamadanin. Në veshjet me brekushe mund të dallojmë këto grupe: Varianti me brekushe të përgatitura me një lloj stogu veror të leshtë por të hollë, ato ishin të bardha për verë ose të leshta me ngjyrë kafe të mbyllur për dimër.

Variante me brekushe prej pëlhure të bardhë pambuku ose liri, që thirreshin “brakesha”. Grupin e tretë e formojnë ato zona ku brekushet u përhapën kryesisht nga fillimi i shekullit XX duke zëvendësuar kostumet e mëparshme që dalin nga përdorimi. Për këtë arsye ato shoqëroheshin shpesh herë, në pjesën e sipërme të trupit, me pjesë të veshjes së mëparshme.

Veshja me tirq-tirqit janë pantollona të ngushta prej shajaku të bardhë e ndonjëherë të murmë ose zi, me dy shqeka përpara, që ngjiteshin pak më poshtë belit. Tirqit njiheshin me emrat “çakçirë” dhe “xhedikë”, që janë fjalë të burimit turk. Tirqit kanë origjinë mjaft të lashtë.

Veshja me shallvare-shallvaret janë një lloj pantollonash prej cohe, shumë të gjëra nga beli deri në këmbë e të ngushta poshtë; veshje e tipit oriental. Shallvaret punoheshin prej cohe (stofit) me ngjyrë të kuqe, të gjata deri në gju dhe të gjëra në pjesën e sipërme. Në brej ishin të mbajtur me një ushkurë gjërë prej mendafshi.

Veshja me fustanellë-fund i gjërë, me kunda e rrudha që ngjishej përmes, arrinte deri te gjunjët. Fustanella ishte kryesisht e bardhë, e bërë me pëlhurë të pambuktë, të punuar në shtëpi ose fabrikuar.

Veshja me branovekë-meqë fustani mbahej nga burrat e besimit myslimanë, branovekët ishin veshje popullore qytetarëve të besimit katolikë. Branoveku bëhej prej perkaline të zezë të importuar ose prej pëlhure pambuku të punuar në vend.

VESHJA PËR GRA

Veshja e parë e nuses ishte këmisha e gjatë deri në gju, e mëngë shumë të gjëra dhe jo shumë e hapur në gjoks. Këmisha lihej kryesisht prej mendafshi melezi, por liheshin edhe prej façelli të bardhë, kjo sipas gjendjes shoqërore të asaj që mbante. Këto këmisha qëndiseshin me fije ari e laxhyhera ose prej mendafsh në mëngë dhe në grykë.

Veshja e gruas myslimane të moshuar-plakat vishnin këmishë prej pëlhure pambuku, anteri të mbyllur po prej pambuku ose cohe, branovekë prej cohe të rëndomtë ose basmë me një jelek pa harxhe. Veshja e gruas katolike në këtë veshje përmendim këmishën e gjatë deri në pulp të këmbës, me mëngë të gjëra dhe e hapur në gjoks. Gryka e këmishës punohej me gjilpër në vete dhe pastaj iu qëndiseshin këmishave tek pjesa e hapur. Përdorreshin dy lloje këmishash: harkore dhe meleze,

Veshja me xhubletë-xhubleta është një fund që vjen i hapur në formë këmbane të valzuar, sidomos në pjesën e prapme të tij. Ai bëhej prej rripash e cpash shajaku, me një prerje shumë të ndërlikuar që donte mjeshtri të madhe në të qepur, që mund të merrte gjërësinë dhe valëzimin e dëshiruar.

RINIA DHE ATDHEDASHURIA

*Gjuha jonë sa e mirë!
Sa e ëmblë, sa e gjerë
Sa e lehtë, sa e lirë!
Sa e bukur, sa e vlerë...*

Kjo porosi e poetit tonë të madh Naim Frashëri, çdo ditë e më shumë po harrohet. Gjuha jonë gjithmonë e më shumë po përzihet me fjalë të gjuhëve tjera. Kjo dukuri është sidomos shumë e shfaqur në mesin e shqiptarëve në Mal të Zi ku gjuha jonë po bie pre e sllavizmave. Po të dëgjosh bisedat e të rinjve tonë është e vështirë të dallosh se çfarë gjuhe flasim, sepse çdo e treta fjalë nuk i përket fjalorit të gjuhës shqipe, e në pjesën dërrmuese ato fjalë i përkasin gjuhëve sllave. Gjuha jonë ka një fjalor shumë të pasur dhe absolutisht çdo emërtim apo gjësend e ka fjalën përkatëse burimore shqipe, prandaj nuk është nevoja që në vend të fjalëve tona të përdorim fjalë të gjuhëve tjera.

Kjo dukuri e përzierjes së gjuhës tonë është një prirje e gabuar që rrezikon çdo ditë e më shumë gjuhën tonë e cila u ka bërë ballë mijëvjeçarëve e pengesave shumë më të mëdha që historia ia ka vënë përballë. Është një mëkat që këtë gjuhë e cila është ndër më të vjetrat në botë të mos e ruajmë dhe përdorim ashtu siç na e lënë trashëgim të parët tanë. Nëse ne nuk e ruajmë gjuhën tonë, pyes kush tjetër do të na e ruajë?!

Të dish sa më shumë gjuhë është shumë mirë, por duhet të dijmë se kur flasim gjuhën tonë duhet ta flasim pastër dhe të papërzier.

Gjuha është shtylla e identiteti kombëtar dhe kur humbet ajo humbet edhe përkatësia kombëtare. Dukuria e përzierjes së gjuhës është rrjedhojë e mungesës së atdhedashurisë në mesin tonë. Të jesh atdhetar nënkupton që të gjithë së bashku të punojmë për përparimin e popullit tonë. Të gjithë duhet të ruajmë vlerat kulturo-historike tonat dhe të mos i lëmë në harresë. Atdhedashuria sot ka marrë formë tjetër, por që në brendi nuk ka ndryshuar shumë. Të jesh atdhetar nuk ka në mënyrë absolute asnjë lidhje me shovinizëm apo me urrejtjen ndaj popujve tjerë, por që të duam dhe të ruajmë atë që është me të drejtë e jona. Figurat dhe personalitetet shqiptare të cilët kanë lënë gjurmë në historinë botërore janë të shumtë duke filluar nga Gjergj Kastrioti, Mehmet Aliu i Egjiptit, Nënë Tereza, Ismail Kadareja etj. Përkundër padrejtësive dhe mizorive që populli ynë ka kaluar ndër shekuj ne kemi arritur që të ruajmë identitetin tonë kombëtar. Ne kemi se me çfarë të krenohemi dhe duhet të jemi krenar që jemi shqiptarë.

Kjo ndjenjë për fat të keq po humb çdo ditë e më shumë e sidomos në rradhët e të rinjve. Një pjesë e tyre nuk i ka as idetë dhe as njohuritë më të vogla mbi historinë e popullit tonë. Të flasësh për atdhedashuri sot konsiderohet jo e kohës dhe ndonjëherë edhe qesharake. Kjo është një dukuri shumë e dëmshme e cila duhet hequr para se të jetë vonë.

Rrënjët e përparimit të çdo populli janë në vet lidhjen në mes vete dhe në atdhedashurinë e tyre. Andaj gjuhën si bazë e identiteti tonë kombëtar dhe poashtu historinë, traditat dhe popullin tonë duhet t'i ruajmë si gjënë më të shtrenjtë për ne. Kjo është e vetmja rrugë e përparimit të popullit tonë dhe fitimit të respektit në rradhët e popujve tjerë.


Mbani mend se:

"Ai që nuk e njeh dhe vlerëson historinë e popullit të vet sot e 3000 vite më përpara, jeton sot për nesër..."

Endrit Avdiu III-4

"JETA E NJË MATURANTI"

XHEMIL DODA



ZEMRAT KËRKONIN NJËRA-TJETRËN...

Ai dhe ajo ishin maturantë, shokë të së njëjtës klasë. Dashuronin njëri-tjetrin pa djallëzi, në heshtje nuk shprehnin ndjenjat për njëri-tjetrin. Alfonsi dhe Pesenta, me një zemër që rrihte për njëra-tjetër...

Meqenëse Alfonsi ishte më i miri i klasës, Pesenta kërkoi nga ai disa spjegime për detyrat e matematikës. Si vendtakim i tyre ishte "Hija e Gështenjës". Detyrat e matematikës u bënë shkak që shprehnin dashurinë për njëri-tjetrin. Dy zemra u bashkuan dhe tik-taket e tyre dëshmonin se nuk dëshironin të ndaheshin përjetësisht. Nën qiellin e qeshur dhe yjet që shkëlqenin, ai i tha se e donte vetmja pengesë e tyre ishin përkatësitë fetare sepse vajza ishte myslimane e djali katolik.

Por dashuria nuk njih moshë, fe e as kohë, ajo troket në zemër dhe don të flejë aty përjetësisht.

JETA E LËNË PËRGJYSËM, ËNDËRRA TË LËNA NË MES...

Shumë shpejt u zbulua dashuria e dy të rinjëve, prindërit i ndanë dhe njerëzit i gjykonin. Dy fe të ndryshme s'i bashkoni dot në martesë. Pse? Zemrat e dashuruara u thyen në thërime, dashuria e tyre s'mundi të triumfojë. Jeta u la përgjysëm. Vajza jetën e ëndërrat duhet t'ia falte dikuj tjetër sepse prindërit e martuan me një tjetër. Edhe pse e martuar asnjëherë nuk mundi të harrojë atë që e mërzite se ç'do të thotë dashuri. Nuk zgjati shumë kjo martesë pasi që Pesenta u nda nga bashkëshorti e Alfonsi i lënduar u largua për në luftën e Spanjës. Në atë luftë u plagos rëndë, kurse në vendlindje erdhi lajmi se ai kishte vdekur. U desh të kalonin kohë, që Alfonsi të kthehej në vendlindje e të ndjente dashurinë njëherë se sa pranë dashurisë ishte.

SHUMË PRANË DHE SHUMË LARG NJËKOHËSISHT...

Tashmë Pesenta e Alfonsi qëndronin të vetëm, në të njëjtin qytet. Ditët kalonin, muajt poashtu, ai dhe ajo mbeteshin në të njëjtën situatë. Të dy të lënduar, të dy të trishtuar por gjithashtu të dy që mund të heshin të pranonin realitetin e jetës së tyre. Një vajzë që dashuronte e vuante për një djalë dhe një djalë që vuante për një vajzë dhe jo se ajo nuk e donte, por nuk kishin guxim ta jetonin këtë dashuri. Pse vallë kishin frigë? Sepse njerëzit gjykojnë, ato ndikojnë në jetën private të dikujt tjetër. Si është mundur që ligësia e kësaj bote të arrijë në një pikë që nuk tolerohet. Si mund të ndani dy të dashuruar? Pa më thoni, kush paguan për dhimbjen e tyre, për netët e pagjumësisë, për ëndërrat e thyera? Ishin kaq pranë me zemër por edhe aq larg fizikisht. Sa pak kërkonin nga jeta; të takoheshin edhe njëherë të vetme. Ky takim duhej të realizohet dhe dy të rinjtë e arritën përmes shoqës së tyre Medihasë.

TAKIMI QË TREGOI SE DASHURIA NUK ISHTE SHUAR...

Nën "Hijen e Gështenjës" çeli përsëri trëndafili i harruar nën shelg. Alfonsi dhe Pesenta u takuan. Dashuria i kishte tretur, Pesenta ishte sëmuar rëndë. Lotët që rridhnin si stuhi e psherëtimat e rrufeshme, nuk i lanë që buzët e tyre të bashkoheshin. Dy të rinjë që torturojnë veten dhe shkatërronin një jetën e tyre vetëm se bota është e lig të gjykon, të përgojon pa të drejtë. Ç'mëkat, o njerëz!! Ç'mëkat! Dashuria s'duhet të dhëmb, ndonse është dhimbja më e bukur në botë e zemrat e thyera rrahin përsëri me shpresë se nëse nuk i bashkon kjo botë, ndoshta "bota tjetër" do të ketë mëshirë do t'i bashkojë.

Sekretet në shkollë

Si të dalim në krye me prof. e vështirë?

Pajtohu me realitetin-askush s'i ka të gjithë prof. e mirë. Të lumtur janë ato që kanë më shumë se dy persona simpatik me ditat në duar. Por nga ato persona s'mund të ikësh (mundesh në shkollë tjetër, por ku ta dish se si janë edhe atje), për atë shtërngo dhëmbët dhe numro deri në 0.

Nëse prof. me të vërtet nuk sillen ndaj teje ashtu siç e ke merituar, atëherë bëhu gati për aksion. Më së miri kishte për të qenë që atë prof. ta pyesësh se çka është saktësisht problemi, shmangu agresivitetit dhe tonit sulmues. Duhesh më shumë t'i përngjash një kaprolli të hutuar se sa një ujku të çmendur.

Nëse mendon se diçka ashtu s'do të mundesh, atëherë luti prindërit ta bëjnë atë gjë në vendin tënd. Ato do të gëzohen që ti po merresh me shkollë, çfardo aspekti ai të jetë.

Para se ta fillosh mbrojtjen tënde, mirë mendo se ai sulmues e ka ndonjë arsye të veçantë që të mos dojë. Përmende çdo gabim tëndin, e pastaj premtë që do të mundohesh t'i përmirësosh. Dhe le të dukesh i bindshëm, edhe pse mbas shpine i ke gishtërinjt e kryqëzuar.

Fjalë të urta

• Ju qeshni me mua sepse jam ndryshe nga ju, ndërsa unë qesh me ju sepse jeni të gjithë njësoj.

• Nuk ka gjëra jointeressante, por ka vetëm njerëz të painteresuar.

• Keqardhja për gjëra që ke bërë në jetë zbehet ngadalë, ndërsa keqardhja për gjërat që nuk mund t'i bësh është e paharrueshme.

• Perëndia s'do ta ndryshojë dot gjendjen e vështirë të një populli, për deri sa ai popull të mos e ndryshojë vetveten.

• Përkohësisht ne jemi poshtë, përkohësisht ju jeni lartë. Do vij një ditë, do vij një orë kur do të gjendemi përballë.

• Mrekullia nuk është as të fluturosh në ajër, as të lundërosh në det, por të ecësh në tokë.

Kollashini, një eksperiencë e re për gjimnazistët e shkollës sonë

Një përvojë e re iu ofrua nxënësve të shkollës sonë me anë të organizimit të një skolle skijimi tre ditore që u organizua nga data 26-28 shkurt, me qëllim mësimin e skijimit si disiplinë sportive. Numri i nxënësve nuk ishte edhe aq i lartë (33 nxënës), mirëpo e gjithë kjo ndodhi për shkak të pamundësive financiare apo për ndonjë arsye të dytë.

E gjithë kjo u organizua për herë të parë me nismën e mësimeve të edukimit fizik Rrok Lulgjuraj dhe Kadri Sinanit. Ky organizim ka qëllim të shumëfishtë të edukimit të nxënësve, të fitojnë një kulturë të re shëndetësore dhe të zbavitur.

Për fat të mirë të nxënësve pjesëmarrës ka mbretëruar një mot i mirë, me mjaft borë.

Fillestarët arritën të mësojnë skijimin fillestar, ndërsa ato që veç patën eksperiencë në këtë sport e përvetësuan atë më mirë.



Perlat

Nxansi tu vet për 3)

prof. Elezi: Msej 30 definicione.

x: Për tresh 30 definicione? E dmth për njish 10 definicione e?

prof: Edhe për njish duhet me dit diçka.

prof. Hyrija: Latif çka isht dallimi në mes të Hitlerit dhe Stalinit?

atifi: Pa prof. Hitleri e ka ma t'vogël, e Stalini ma t'madh.

prof: Keeeeen??

atifi: Mjekrrën moj.

prof. Alija: Kemi qeniet e gjalla dhe qeniet e gjalla të vdekura.

prof. Dauti: Dil përjashta Nikaj!

giani: Lene mar prof. at masllahat. (edhe nuk del jasht)

ana: Prof. si i thohet alkholliçarve shqip?

oni: Pijaneca moj...

eshet prof. Qemali.

idita: Çka isht prof.?

of.: E hane.

FJALORI POLITIK

Artist - Fukara i kombit!

Farmacit - Ilaç pa garanci!

Replikë - Show politik!

Banalitet - Normalitet!

Progres - Prapakthesë!

Unitet - Gjithkush me kokë të vet!

Pension - Lëmoshë që kërkon!

Spital - Han me bluzë të bardhë!

Vizë - Identiteti në krizë!

Stres - Truri nën pres

Emigracion - Anije pa timon!

Destruktiv - Politikan me perspektiv!

Kuvend - Tubim me piskamë

Premtim - Një hap para e tre prapa

Korrupsion - Vjedhje me vagon!

5 udhezimet që duhet të ndiqni për të mbajtur trupin tuaj në formë:

Trup i shëndetshëm është një frazë që përfshin disa kuptime. Idetë që ju vijnë në mend janë më të zakonshme individuale sesa standarde. Gjithmonë është e çuditshme të dëgjosh njerëzit kur thonë se trupi i shëndetshëm për shumë njerëz mund të prezantohet nga një formë e mirë fizike, apo siç thuhet në gjuhë mjekësore, shëndet kardiovaskular. Në të njëjtën palestër, megjithatë, çdo ditë mund të shohësh njerëz, të cilët duken njësoj si disa vjet të shkuara. Përse këta individë nuk kanë ndryshuar aspak në atë kohë? U mungojnë njohuritë në këtë fushë? Apo nuk po stërviten me intensitetin e duhur? Mbase po ju paraqesim dhe rekomandime ose hapa të thjeshtë për të ndihmuar transformimin e trupit tuaj në një të ri, më të shëndetshëm.

1. Pini sa më shumë ujë.

Uji është një element i rëndësishëm për organizmin e njeriut. Pini sa më shumë ujë gjatë ditës. Rekomandimi ditor për ujë është 8-10 gota në ditë. Uji është shumë i rëndësishëm, sepse ndihmon tretjen e ushqimit, shpejton metabolizmin e trupit, e shpëlan organizmin gjatë ditës dhe në të njëjtën kohë është shumë i rëndësishëm për funksionimin e kyçeve të trupit, si gjunjët dhe bërrylat. Një e mirë tjetër është që të bën të ndjehesh i ngopur, pa ngrënë shumë kalori.

2. Konsumoni ushqim cilësor.

Trupi është një si makinë, dhe si çdo makinë ai ka nevojë për karburant për të funksionuar mirë, me karburant me cilësi. Mbani mend, makinën mund ta ndërroni sa herë që të doni, por trupin e keni vetëm një. Sa të vdisni, kështu që trajtojeni mirë. Zakonisht, 5-6 porcione të vogla ushqimi është më mirë sesa 2 porcione: mëngjes, drekë dhe darkë, që ne jemi mësuar të hamë. Porcionet më të vogla treten më shpejt në sistemin e tretjes dhe i japin më shumë energji trupit. Kini kujdes! Këto porcione duhet të përmbajnë me tepër proteinë dhe më pak karbohidrate. Një porcion ushqimi duhet të ketë një njësi proteinë dhe një njësi karbohidratesh. Një mënyrë tjetër për të peshuar është me masën e dorës. Është më e thjeshtë dhe e arsyeshme. Për shembull: masa e dorës grusht është një njësi karbohidrate, ajo është zakonisht një patate apo një portokall, ndërsa masa e një proteine është sa dora e hapur e matur gishtat. Kjo është zakonisht masa e një bërçolle.

3. Bëjeni zakon stërvitjen.

Të paktën tri herë në javë, në mëngjes, shkoni në palestër dhe vraponi, ose bëni biçikletë për 45 minuta. Pastaj, pas punës, rreth orës gjashtë apo shtatë, bëni stërvitje me pesha për rreth 45 minuta. Është vërtetuar që diçka duhet të përsëritet 21 herë para se të bëhet zakon. Pra, të paktën 21 herë shtyjeni veten për të shkuar në palestër. Atëherë do ta ndieni ndryshimin menjëherë.

4. Stërvitje force.

Këtu bëhet fjalë për stërvitjen me pesha. Si për meshkujt, edhe për femrat stërvitja me pesha nuk është zëvendësim. Është mënyra më e mirë për të shtuar masë muskulore, që ndihmon në djegien më të shpejtë të kalorive dhe ndihmon në zbulimin e formave të trupit. Tri deri në katër herë në javë, për 15-20 minuta deri në një orë, është e mjaftueshme për të arritur këtë synim.

5. Stërvituni me një shok.

Kjo mund të jetë këshilla më e rëndësishme që ju jepet. Ndjehemi gjithmonë më të rehatshëm kur kemi dikë me vete. Ndaloni dhe mendoni për një minutë. Kur niseni për të blerë diçka në dyqan, gjithmonë merrni një shok me vete, për t'ju ndihmuar dhe për të kaluar atë fazën e paretshme të zgjedhjes së rrobave. Një arsye për të pasur gjithmonë një shok është se sa herë që ndjeheni të lodhur apo të stërvitur, ar dhe s'e keni mendjen për stërvitje, e dini se shoku juaj po ju pret në palestër apo në park për t'u stërvitur. Një shok gjithashtu është i rëndësishëm për t'ju shtyrë sa më tepër për të vrapuar atë kilometër fundit, apo për të ngritur ato dy përsëritjet e fundit të peshave. Ashtu si në jetë, çdo njeri ka nevojë për një partner për të përballuar dhimbjet e fundit të peshave. Ashtu dhe çdo njeri ka nevojë për një partner për të përballuar dhimbjet e muskujve.

Bukuroshet shqiptare

Emina Çunmulaj - iu deshën 17 vjetë shqiptarëve për të pasur një supermodele që do ti prezantonte në fushën mbarëkombëtare të modës. Edhe pse ka pasur vajza të tjera, të cilat kanë njohur sukses jashtë vendit, asnjëra prej tyre nuk mund të krahasohet me Eminën. Ajo është e para modele shqiptare që ka arritur të dalë në kopertinat e modës, si "VOGUE" dhe "MARIE CLAIRE" dhe po e para që ka sfiluar pothuajse të gjithë stilistët më të njohur si:

D&G, CAVALLI, VALENTINO, VERA WONG, ARMANI, FERRETI, MARC JACOBS, YSL, OSCAR DE LA RENTA, etj. Fotot e saja janë kudo dhe e vetmja arsye që ndoshta i ka shpëtuar syrit. Edhe se si një kameleon, pamja e Eminës ndryshon nga fotoja në foto deri në detaje. Diku ajo shfaqet e ëmbël dhe ëngjëllore, diku një zonjë e klasës së lartë, e diku një femër fatale me shikim intimidues.

E lindur në Miçigan të SHBA-së, me prindër shqiptarë nga Malsia e Madhe, Emina Çunmulaj është një prej modeleve më të kërkuara në fushën e modës, ndërsa për ne shqiptarët, ajo është surpriza më e bukur që ka ndodhur në artin shqiptarë.

Afërdita Dreshaj - modelja shqiptare Afërdita Dreshaj tashmë arriti kulmin e realitetit. Për ne është një kënaqësi edhe më e madhe pasi që, Afërdita i ka rrënjët e ngulitura thellë në trojet tona. Ajo është shqiptare nga Mali i Zi (Tuzi) e cila jeton në Amerikë dhe po korrë sukses jo vetëm aty por edhe në të katër anët e botës. Bukuria e sajë rrëmben me vete shpirtin e çdo njeriu. Afërditën mund ta shohim kudo: në televizor, në kopertinat e gazetave më të famshme, në sfilatat më të njohura të modës, bile kohët e fundit edhe në skenë pasi që Afërdita është provuar edhe në sferën e muzikës. Ajo është fejuar me këngtarin maqedonas Shpat Kasapin dhe së shpejti po planifikojnë martesën.

Të keshë bashkëatdhetare një bukuroshe si Afërdita është kënaqësi.



Teuta Gjeçbitriq I-5

Karvani i katër viteve

Testamenti çdo vit po lihet
Po bëhet monotone thonë
Por gjithsesi mos u mërzitni
Se ne po e japim versionin tonë
Po fillojm me këmb të mbar
Me gjuhën e dashur amë
Me ne shumë ka hjek zi
Profesoresh Hava Pereziziqi
Me i shku në orë pak e "zhveshur"
Nuk pranon justifikime
Me kritik na shikonte
"Vajz mbuloje atë pjes intime"
Po ëns thot gjuha zyrtare
Aty të dalin ment fare
Profesoresh Lila shumë është mundu
Dy fjal serbisht me na i msu
Por ne fort se kemi nigju
E kështu na ka dënu
"hajde sjedi jedinicu"
Hajt o profesoresh kasavet
Se na 1 e cojm prep
Profesoresh keq për këto fjal
mos na gjyko
Sepse "mi te volimo"
Gjuha angleze shumë na ka lodh
45 minuta ishin sa 100 or
Njëher profesoresh Florina e
pastaj Edina
Kur fillonte mesimi ne na binte
pika
Eh moj Edin shumë keq me ne
hoqe
"Në test jam polic e në or jam
shoqe"
Gjuha gjermane ishte lezet
Aty vepronim si donim vet
Profesor Gazmiri me na qetsu e
ka pas mezori
"uluni shpejt se ardhi drejtori"
Me msu aspak sjena mundu
Se tan vitin as 5 or si kena shku
Profesoresh Valbona ne
matematik
Donte lenden mir me ja dit
Shum prej neve aty kan msu
Se përndryshe 1 kishim fitu
E për me përmirsu 1 në
matematik
Duhet me msu nat e dit

Matematikes ja bajm hallall
Po per filozofi e etik çka me than
Skender Muça këto dy lënd na i ka
dhan
E na ka myt të drejten me than
Kur ia nis ai e flet
Ah txe gjumi per lezet
"dëgjo mua këtu çka them
Se përndryshe jasht tash po del
Këtu kena ardh me mësu
E jo tër oren me u shminku"
Çdo orë nga një mësim të ri
Por kot për ne spatën dobi
Po Daut Doda në sociologji
Na ka ba me hjek zi
"dil ulu në bank me u pyt vet
Se nxansi jem krye fakultet"
Hajt profesor se kot po flet
Se fakultetin e kryjn tan që kan
"lek"
"vajz mas u ngerdhesh
Se të qes jesh itesh"
O profesor uh un kta msime "i
teri"
"lene iher ti se tash po tkrehi"
Por për histori çka me than
Fatbardha ka qen zonj e ran
Fjalet e saja ishin me vlerë
Sdo ti harrojm asnjeher
Kemi mësu histori e kemi mësu
për jeten
Por pak kemi mësu me than të
drejten
Por na e ka prish kur është detyru
Me Hyrijen me u zëvendësu
Hyrija me msime na ka mbyt
"Hajt shkruni shpejt në fletore
Lufta I e lufta II botërore"
Po çka na duhen ne këta pun
Ne na duhet e tashmja e jo ata që
shkun
Por kur nuk na u shkante në or
Iknim tan klasa për qefin tonë
Latinisht tek profesor Rasimi
Aspak nuk kena msu
Kur na binte qefi në or kemi shku
"mu nuk më duhet gja po pervedi
ndaçi me msu"
Prtofesor gjuha latine është e
tretun
Ajo ka 1 shekull qe ka vdekun

Ora qefit qe skemi ba asgj
Ishte fiskulltura
Asnji or nuk kena shku
se salla ishte pa u ndertu
e kur Rroku në nëntor
notat vinte me na i vu
thoshte "2 se në pllazh shku"
po si u shkoka në nëntor
npllazh me u la
po vene 2 se fiskulltura s
duhet gja
për në fund lihet ëmbëlsira
kujdestar Selatini e kimia
për kimi skena çka me than
se kurr si kena shku në or
e ato nota qe kena marr
pak kena dit e pak na i ka fa
"o kastravec, o çakulan
Msa e mas rri si hajvan"
Dy fjal per kujdestarin ton
Me gjith qef na pa i thom
Selatin të falemderojm
Se shumë te kemi nervozu
"ah ju çka pa mbani mu
Ditari plot verejtje e munges
Un si me ju arsyetu
O ju jeni kastraveca"
Edhe pse na ka qortu
Ne fund krejt na i ka arsyetu
Faleminderit ju profesorë
Për durimin qe patet me ne
Rinia është e shfrenuar
E ne me ju ishim pak "pa fre
Ju kerkojm ndjes për këto
vargje
Të na falni nëse jeni ofendu
Ne pak deshëm të luanim
Po dikur kemi me ju nderu
Edhe ne do të harrohemi
Si maturantet e tjerë më pa
Por çastet e gjimnazit do i
mbajm ne zemër
E emrat tonë do ruhen në
ditar...!!!!